



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KABINETI

NJOFTIM PËR SHTYP

Rasti: Përftimi i kontrollit të shoqërisë ApNet SHPK nga shoqëria ABCom SHPK.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar shkresa Nr.276 Prot., Protokollit i AK, datë 21.07.2020 “Njoftim”, me të cilën jemi njoftuar mbi transaksionin e përfimit të kontrollit të shoqërisë ApNet SHPK nga shoqëria ABCom SHPK.

Sipas marrëveshjes “Kontratë Shitblerje Kuotash”, datë 06 Mars 2020, ndërmjet shoqërisë ABCom SHPK dhe shoqërive Intel Media SHPK (Shitësi 1) dhe Teeb-Center SHPK (Shitësi 2), palët janë:

Pala blerëse: ABCom SHPK, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, e regjistruar më datë 08.01.2001. Objekti i shoqërisë është të ideojë, zbatojë dhe të menaxhojë rrjete të telekomunikacionit dhe transmetimit të të dhënave dhe interkoneksionet në përgjithësi, të sigurojë shërbime audio dhe/ose audiovizive etj

Pala shitëse:

Shitësi 1: Intel Media SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar. Objekti i shoqërisë është shërbime në lidhje me turizmin, online marketing, programim dhe implementim që lidhet me produkte digitale, ndërmjetësim ndërmjet klientëve dhe provider të moduleve teknologjike të prenotimeve online.

Shitësi 2: Teeb-Center SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar. Objekti i shoqërisë është ofrimi i shërbimeve telefonike të lëvizshme dhe të palëvizshme në shkallë kombëtare, shërbime radioje, shërbime globale të komunikimeve, eksport, import të mallrave të ndryshme.

Target: ApNet SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, e regjistruar më datë 10.03.2020. Objekti i shoqërisë është ofrimi i shërbimit të komunikimeve elektronike, kryesisht transmetime televizive kabllore dhe shërbime marketingu për palë të treta.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.